



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 43
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203
Prishtinë, më 18 qershor 2019, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Flora Brovina, Drita Millaku, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Miljana Nikoliq.

Stafi mbështetës: Shprese Ramosaj-Haxhijaj, koordinatore dhe Greta Avdyli, praktikante.

Pjesëmarrës tjerë: Alban Avdiu – KDI, Mirlinda Zhushi-GP LDK, Nexhmie Hyseni – Ekonomia Online, Albert Bislimi – Ekonomia Online, Fisnik Galani – HANDIKOS, Kushtrim Xhemali – GP AAK, Paulina Nushi - BIRN dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi: Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 17.05.2019 dhe 23.05.2019;**
- 3. Takim me ministrin e Shëndetësisë z. Uran Ismaili,**
 - Procesi i revidimit të listës esenciale të barnave dhe përfshirja e barnave për sëmundjet e rralla.
 - Informatë rreth furnizimit të SHKUK-së me infuzione.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Në mungesë të prezencës së Ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, pika e tretë u largua nga rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 17.05.2019 dhe 23.05.2019

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 17.05.2019 dhe 23.05.2019, u miratua pa asnjë ndryshim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social

Kryetarja tha se projektligji është proceduar në komisionet e përhershme, gjegjësisht në Komisionin për Legjislacion, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Komisionin për Integritet Evropiane. Ajo theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka potencuar se amendamenti 8, i cili ka të bëjë me pagesën për komisione, paraqet buxhet shtesë, sidoqoftë është i përballeshëm për buxhetin e Republikës së Kosovës. Kryetarja tha se të gjitha komisionet kanë dhënë opinionet dhe komentet e tyre pozitive sa i përket këtij projektligji. Kryetarja hodhi në votim Raportin me amendamente për Projektligjin për Këshillin Ekonomiko Social në mënyrë që të procedohet pastaj në seancë:

Komisioni me 5 vota për, asnjë votë kundër dhe dy abstenime të deputeteve Fatmire Mulhaxha-Kollçaku dhe Drita Millaku, procedoi për seancë raportin me amendamente për Projektligjin për Këshillin Ekonomiko Social.

4. Të ndryshme.

Kryetarja diskutoi rreth Kërkesës nga Sindikata e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë shëndetësor, ku ka pas kërkesa edhe rreth mos zbatimit të Kontratës Kolektive. Kërkesa e cila është cekur në këtë shkresë ka të bëjë me Ligjin e Pagave, ligj i cili ka kaluar në Kuvend dhe po punohen aktet nënligjore. Kërkesa i drejtohet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që të marrë një iniciativë për plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Ajo tha se ata ishin të zhgënjyer nga Federata e Sindikatës së Shëndetësisë duke theksuar se bashkëpunimi nga ana e tyre ka munguar. Megjithatë komisioni ka shqyrtuar secilën kërkesë, qoftë të Federatës apo të Odës së Mjekëve. Kryetarja dha qëndrimin e saj të padiskutueshëm se duhet të rritet koeficienti i infermierëve.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku tha se duhet t'i përgjigjemi kërkesës, mirëpo fillimisht duhet të ftohet Ministri i Shëndetësisë dhe ta pyesim se a do të ketë ndryshim të koeficienteve. Sipas saj

infirmierët duhet ta kenë koeficientin e njëjtë pa përjashtime. Ajo përkrah kërkesën e tyre, përkundër faktit se është skeptike sa i përket pamundësisë së ndërhyrjes si komision.

Kryetarja tha se beson se problemi i kategorizimit qëndron vetëm tek Administrata Publike se ku do të specifikohen dhe se në cilën kategori do të jenë zyrtarët dhe nëpunësit. Ajo shpreson që ky kategorizim të mos ndodhë në Shëndetësi për shkak se sipas saj specialist është si ata që punojnë në Institutin e Shëndetësisë Publike, si ata që punojnë në Specializime Operative, pasi që të gjithë janë të barabartë sa i përket shkollimit të tyre.

Bekim Haxhiu tha se ka bërë një amendament 17 faqe në Projektligjin për pagat ku kanë qenë të përfshirë dhe të vlerësuar infirmierët e të gjitha kategorive sipas shkollimit që kanë. Edhe pse ky amendament është përkrahur nga komisioni, në Kuvend është kundërshtuar nga shumica e partive politike, duke u përkrahur kështu vetëm në mënyrë individuale nga deputetë të cilët kanë pasur një vizion për zgjidhjen e këtij problemi. Sipas tij kjo kërkesë në aspektin e saj përmbajtjesor ka defekte substanciale, për shkak se në aspektin procedural komisioni nuk mund të plotësoj-ndryshoj ligje përpara se të filloj zbatimin e Ligjit. Ndërsa sa i përket aspektit substancial në sistemin shëndetësor nuk ka infirmierë të fiziatrisë, stomatologjisë dhe as të gjinekologjisë. Ka infirmierë, ndihmës infirmierë dhe infirmierë të përgjithshëm, të cilët mund të punojnë në sektorin primar, sekondar, terciar në cilëndo klinikë. Me koeficientin 3.2 janë psikologët klinikë, fizioterapeutët dhe logopedët. Ai mendon se në vitet në vijim, në qoftë se do të ekzistojë ky diferencim mes Qendrës Klinike Universitare dhe Fakultetit të Mjekësisë do të ketë probleme për specializime, pasi që specializimin nuk mund ta monitorojë askush përveç profesorit. Ai mendon se të gjithë infirmierëve duhet t'u rriten pagat prej 30%, sidomos atyre me nivel bachelor.

Time Kadrijaj tha se komisioni ka qenë i përkushtuar sa i përket nivelit të pagave dhe koeficientit, duke mbajtur kështu takime me profesionistë në mënyrë që të përkrahet sektori shëndetësor. Ligji i Pagave i trajton me dinjitet të gjithë profesionistët. Ajo tha se ky ligj është sukses për Kosovën dhe se duhet të pritët faza e implementimit të tij. Sipas saj tash është shumë më lehtë të rregullohet sistemi i pagave për shkak se janë vetëm katër apo pesë sektorë që janë të pakënaqur dhe Qeveria mund të lejojë rregullimin e tyre.

Fikrim Damka tha se për kërkesën e infirmierëve për ngritje të koeficientit, duhet së pari të implementohet ligji dhe më pas të bëhet plotësim-ndryshimi i tij apo të shqyrtohen mangësitë e ligjit. Sipas tij duhet të fokusohemi në kërkesën e infirmierëve që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit të Punës, për shkak se do të ishte ndihmesë shumë e madhe pagesa shtesë e infirmierëve për punën jashtë orarit ose punën shtesë duke përfshirë vikendet.

Drita Millaku tha se në bazë të kërkesës dhe takimeve me infirmierë të kategorive të ndryshme vërehet qartë diskriminimi sa i përket koeficientit të tyre dhe pagave. Sipas saj komisioni duhet të takohet me ministrin dhe të insistohet që Ministria e Shëndetësisë të punojë rreth kësaj çështje.

Ajo kërkoi nga kryetarja e komisionit që në ftesën e ministrit të Shëndetësisë duhet të përfshihen edhe disa çështje të rëndësishme nga fusha e shëndetësisë.

Enver Hoti shprehu keqardhjen e tij që ekzistojnë diferencime për punë të njëjta dhe profesione të njëjta brenda Ligjit të pagave, që sipas tij duhet t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen. Ai tha se e rëndësishme është që ligji është bërë, pritet implementimi i tij, ndërsa nga komisioni pritet punë e mëtutjeshme sa i përket Ligjit të Punës, sidomos në sektorin privat dhe rritjen e zhvillimit ekonomik. Ai potencoj që kjo Qeveri ka punuar dhe ka proceduar në Kuvend shumë Ligje të rëndësishme dhe shpreson se me procedimin edhe të Projektligjit për Qeverinë do arrihet një punë e mirë. Ai po ashtu falënderoi të gjithë deputetët të cilët votuan Ligjin e Pagave, edhe pse ky ligj mund të ketë hapësirë për rekomandime dhe përmirësime. Ai tha se Ligji për Paga u ka dhënë mundësi kategorive të ndryshme brenda sistemit të pagave qeveritare që të bëjë një dallim dhe avancim profesional karshi vendeve të rajonit.

Kryetarja tha se në mbledhjen e ardhshme të komisionit do të jetë prezent ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismaili ku do të kemi mundësi të marrim opinionin e tij rreth pyetjeve tona dhe më pas t'u dërgojmë përgjigje Sindikatës së Infermierëve rreth kësaj çështje. Ajo më pas mbylli çështjen e koeficientit dhe pagave të infermierëve duke kaluar kështu në një pikë tjetër, atë të formimit të grupit punues për Projektligjin e Punës. Ajo bëri të qartë se komisioni ka vendosur se pa Projektligjin e Pushimit të Atësisë, Lehonisë dhe Pushimit Prindëror nuk do të procedohet në Kuvend Ligji i Punës, prandaj për këtë çështje komisioni do ta thërrasë ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ajo tha se komisioni fillimisht do të formojë grupin punues, pastaj të organizojë dëgjim publik dhe të punojë në projektligjet në fjalë.

Bekim Haxhiu mendon se sa i përket Projektligjit të punës duhet të punoj i gjithë komisioni bashkërisht pasi që ligji është voluminoz dhe ka material të mjaftueshëm për punë e cila sipas tij duhet të ndahet në kapituj. Ai mendon se Ligji i Atësisë, Lehonisë dhe Pushimi Prindëror ka më pak punë. Ai theksoi se në një seancë paralelisht duhet të votohen Ligji i Punës dhe Ligji i Atësisë, Lehonisë dhe Pushimit Prindëror.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku tha se meqenëse ligji është voluminoz është mirë që i gjithë komisioni të jetë pjesë e grupit punues. Ajo theksoi se duhet të vihet në rend të parë mirëqenia e fëmijës, prandaj pushimi i lehonisë edhe ai prindëror duhet të jenë prioritet. Ajo theksoi se mbështet iniciativën dhe punën që po bën Ministria rreth këtij ligji. Sipas saj këto dy ligje nuk duhet të ndahen, mirëpo të procedohen që të dyja në të njëjtën kohë në mënyrë që të mos krijohet vakum ligjor.

Flora Brovina mbështet mendimin se të dy ligjet duhet të procedohen paralelisht për shkak se nëse nuk ndodh kështu do të krijohet vakum i cili do të sjellë edhe shumë probleme të tjera. Ajo përmendi edhe çështjen e pensioneve, ku gratë të cilat lindin më pas nuk kanë stazh pune të

mjaftueshëm për pension për shkak se vitet kur ato kanë qenë në pushim të lindjes nuk po nuk llogariten. Prandaj ajo bëri thirrje që të shqyrtohet secili detaj në mënyrë që përfitues të jetë qytetari.

Haxhi Avdyli tha se duhet të bëhet një rezyme e planit të punës së komisionit, dhe të shikohet pse nuk janë proceduar ligjet të cilat kanë qenë të parapara të vinë. Pra, ka ngecje në Ministrinë e Shëndetësisë në procedimin e Projektligjeve, e theksin e vendos të mos procedimi i Ligjit për shëndetësi.

Ai gjithashtu vë theksin kryesor te statuti i SHKSUK-së, i cili sipas tij duhet të ndryshohet. Ai konsideron se komisioni duhet të kërkojë informata shtesë si nga ministri, po ashtu edhe nga Ministria rreth kësaj çështje. Ai konsideron se Ligi për Shëndetësi është kushtetuta bazë e reformimit të sistemit shëndetësor.

Enver Hoti mbështeti mendimin e deputetit Haxhiu sa i përket informatave shtesë nga ministri dhe Ministria rreth statutit të SHKUK-së, ndërsa sa i përket Ligjit të Punës ai është plotësisht i pajtimit që të formohet grupi punues, pasi që kemi të bëjmë me një ligj shumë serioz dhe përmbajtësor. Sipas tij duhet të punohet konform procedurave ligjore dhe në interes të plotë të funksionimit të këtyre ligjeve.

Komisioni unanimisht u pajtua për formimin e Grupit Punues për Ligjin e Punës në përbërjet të të gjithë anëtarëve të komisionit e që grupin punues do ta kryesojë kryetarja e komisionit znj. Besa Baftiu.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU